

20180110124

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E
TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 199/14, 104/15, 154/15, 192/15 dhe 39/16), në nenin 144-a paragrafi (4) në alinenë 5 lidhëza "ose" zëvendësohet me presje, pas fjalëve "60 pikë" lidhëza "dhe" zëvendësohet me lidhëzën "apo" dhe shtohen fjalët: "- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2)".

Alineja 6 shlyhet.

Neni 2

Dispozitat e nenit 144-a paragrafi (4) pika 5 të Ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 199/14, 104/15, 154/15, 192/15 dhe 39/16) dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji me të cilin në nenin 144-a paragrafi (4) në alinenë 5 shtohen fjalët: "- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2)", nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 3

Drejtori që emërohet në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, obligohet ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtorit i cili nuk do ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".